



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Kryesues i KD-së
Prof. dr. Ismet Salihu

Nr. Prot.: 2/653
Datë: 3/10/2016


Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës, "Hasan Prishtina" në mbledhjen e mbajtur më 29. 9. 2016, mori:

V E N D I M

- I. Studentët që janë përfitues për lirim nga semestri për vitin akademik 2016/17 në bazë të ligjeve përkatëse, janë këto kategori:
 1. Studentët e tri niveleve të studimeve që janë anëtarë të ngushtë të familjeve të dëshmorëve, të zhdukurve dhe invalidëve të luftës së UÇK-së (ushtarak apo civilë) (neni 6, paragr. 8 Ligji Nr. 04/L-054).
 2. Studentët e tri niveleve të studimeve -Veteranët luftëtarë dhe fëmijët e tyre (neni 31 Ligji Nr. 04/L -261).
 3. Studentët e tri niveleve të studimeve që kanë mbetur pa njërin prind si pasojë e luftës-Familjar të viktimave civile të luftës 1.1.1998 - 12.6.1999),
 4. Studentët me nevoja të veçanta në tri nivelet e studimeve,
 5. Studentët e nivelit baçelor dhe master, familjet e të cilëve janë në asistencë sociale.
- II. Studentët që i përkasin kategorisë 1 deri 3, me rastin e regjistrimit të vitit akademik 2016/17, duhet të dorëzojnë vërtetimin origjinal të lëshuar nga Komisioni Qeveritar, për njohjen e statusit të kategorive që kanë dalë nga lufta.
- III. Studentët që i përkasin kategorisë 4 dhe 5, me rastin e regjistrimit të vitit akademik 2016/17 duhet të dorëzojnë vërtetimin origjinal të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
- IV. Familjet kosovare që kanë më tepër se një student në Universitetin e Prishtinës, duhet të aplikojnë për lirim për vitin akademik 2016/17, në njësit përkatëse akademike, pas publikimit të njoftimit nga ana e Rektoratit të UP-së.
- V. Shërbimet e studentëve të fakulteteve përkatëse obligohen që për studentet që i takojnë kategorive të studentëve si në pikën I, të këtij vendimi , që vërtetimet origjinale të cilat dëshmojnë që i takojnë kategorisë përkatëse, të ruhen në dosjet e tyre.
- VI. Ky vendim duke filluar nga viti akademik 2016/17 hynë në fuqi me datë 29.9.2016 dhe vlen deri në nxjerrjen e ndonjë vendimi tjetër.

Vendimi t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së,
2. Dekanëve të njësive akademike
3. Sekretarëve të njësive akademike,
4. Sekretarit të Përgjithshëm të UP-së
5. Zyrtarit ligjor të KD-së.



Prof. dr. Ismet Salihu

Kryesues i Këshillit Drejtues të UP-së